



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA ROSKOVEC
DREJTORIA E KULTURËS DHE NJËSISË SË INTEGRIMIT EUROPIAN

Nr. 823 prot,

Roskovec më 09.02 2023

SHPALLJE
(Per Vend Te Lire Pune)

Pozicioni : Specialist i Prokurimit

Vendndodhja : Roskovec / SHQIPËRI

Me kohë të plotë / të pjesshme: Me kohë të plotë (17 muaj)

Kohëzgjatja: 17 muaj

Afati i fundit për aplikim: 13.02.2023, 16:00 CET

Projekti : Rivitalizimi i Shkollës Qendër Komunitare Kurjan” për akses më të mirë në Zhvillimin Ekonomik dhe Social të të rinjve dhe Grupeve të Disavantazuara” synon të punësojë “**Specialist i Prokurimit**” , për zbatimin e projektit.

Specialist i Prokurimi do të jetë: Përgjegjës për të ndjekur dhe zbatuar procedurat sipas planit të prokurimit dhe në përputhje me politikën, procedurat dhe standardet e projektit dhe Bashkimit Evropian.

Detyrat dhe përgjegjësitë:

- Organizon procedurat e prokurimit për rikonstrukcionin e shkollës Qendër Komunitare Kurjan si dhe procedurat për blerjen e mallrave të kërkuara për zbatim sipas planit të prokurimit dhe në përputhje me politikën, procedurat dhe standardet e projektit dhe Bashkimit Evropian.
- Lehtësimi i menaxhimit të përditshëm të projektit.
- Bashkëpunon me menaxherin financiar të projektit dhe të (SCIDEV) për të menaxhuar burimet financiare të projektit për të arritur rezultatet e projekteve në përputhje me rezultatet dhe aktivitetet e përshkruara në kontratën e grantit

- Ndhomon stafin e Aplikantit Kryesor (Bashkia Roskovec) për të përgatitur raportin e progresit.
 - Identifikon rreziqet dhe ndikimet që lidhen me zbatimin e aktiviteteve
 - Propozon në masat korrigjuese dhe zbaton planet e përshtatjes nëse është e nevojshme, sipas informacioneve të dhëna.
 - Dërgon në kohë të gjithë informacionin e kërkuar tek Aplikuesi Kryesor.

Kualifikimet dhe aftësitë

- Diplomë universitare në Ekonomik ose Juridik
- Aftësi të mira komunikimi me shkrim dhe në të folur, të gjuhës angleze
- Qëndrim konstruktiv, energjik dhe pozitiv në punë.
- Aftësi të mira menaxhuese dhe koordinuese dhe ndjenjë e lartë përgjegjësie

Përvojë e Përgjithshme e Punës

1. Përvoja e mëparshme relevante të punës
2. Përvoja e mëparshme në të paktën një projekt si specialist apo përgjegjës prokurimi.
3. Përvoja e mëparshme relevante e punës me projekte të financuara nga BE ose donatorë të tjerë është e rëndësishme.

Ky pozicion ofron një paketë tërheqëse shpërblimi duke përfshirë një pagë neto konkurruese.

Procedura e aplikimit

Aplikantët duhet të dorëzojnë një letër motivuese dhe një CV në gjuhën angleze/shqip. Mund të përfshihet çdo dokument shtesë përkatës. Aplikimet duhet të dorëzohen jo më vonë se data: 13.02.2023 Në adresën e emailit : enirjetashehu@gmail.com, ose prane zyres së protokollit, bashkia Roskovec.

Në subjektin e e-mail-it/kërkesës duhet të shkruhet : Aplikim për “Specialist i Prokurimit”, projekti, Rivitalizimi i Shkollës Qender Komunitare Kurjan “Për akses më të mirë në Zhvillimin Ekonomik dhe Social të të rinjve dhe Grupeve të Disavantazuara”.

KRYETAR
Majlinda Bufi